

BOTIM STATISTIKOR

SKEMAT E FINANCIMIT TË MENAXHUARA NGA AIDA

2014 - 2019



Rruga Skerdilajd Llagami, Nd.1, Tiranë, Shqipëri
tel: +355(0)42251001 | email info@aida.gov.al | web: aida.gov.al

SKEMAT E FINANCIMIT PËR ZHVILLIMIN E NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME

2014 - 2019

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTIMEVE.....	2
LISTA E TABELAVE.....	2
LISTA E GRAFIKËVE.....	2
HYRJE.....	3
METODOLOGJIA.....	3
LIGJI PËR NVM-TË SHQIPTARE.....	4
TË DHËNA PËR NVM-TË NË SHQIPËRI SIPAS INSTAT.....	4
FONDET E MENAXHUARA NGA AIDA.....	6
FONDI I KONKURRUESHMËRISË.....	6
FONDI NË MBËSHTETJE TË SIPËRMARRJEVE TË REJA START-UP.....	7
FONDI I INOVACIONIT.....	8
FONDI I EKONOMISË KREATIVE.....	9
MENAXHIMI I FONDEVE PËR PERIUDHËN 2014-2019.....	10
BUXHETI I DISBURSUAR.....	10
PËRFUNDIME.....	11
GRATË SIPËRMARRËSE.....	11
SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE.....	11
SHPËRNDARJA SEKTORIALE.....	11
EKSPORTUESIT.....	13
INOVATORËT	13
SIPËRMARRËSIT E RINJ.....	13
NUMRI I PUNONJËSVE.....	14
PROJEKTET DHE FUSHAT E MBËSHTETJES.....	14
HISTORI SUKSESI.....	14

Lista e Shkurtimeve

Shkurtimi	Përshkrimi
AIDA	Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MZHETTS	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
KM	Këshilli i Ministrave
NVM	Ndërmarrje e Vogël dhe e Mesme
SGNK	Skema e Grantit me Ndarje të Kostove
FK	Fondi i Konkurrueshmërisë
FI	Fondi i Inovacionit
FEK	Fondi i Ekonomisë Kreative
FMSRSU	Fondi në Mbështetje të Sipërmarrjeve të Reja Start Up
INSTAT	Instituti i Statistikave

Lista e tabelave

Tabela 1: Komponentët e Inovacionit.....13

Lista e grafikëve

Grafiku 1: Përqëndrimi i NVM-ve sipas viteve.....5

Grafiku 2: Ndërmarrjet me aktivitet ekonomik kundrejt atyre lokale.....5

Grafiku 3: Kontributi në punësim i ndërmarrjeve me mbi 50 të punësuar.....6

Grafiku 4: Gratë në biznes.....6

Grafiku 5: Pësia e secilit fond (në %) mbi buxhetin total për periudhën 2014–2019.....10

Grafiku 6: Aplikimet dhe përfituesit në vite.....10

Grafiku 7: Vlera e financuar në periudhën 2014-2019.....11

Grafiku 8: Gratë sipërmarrëse përfituese11

Grafiku 9: Shpërndarja sipas rretheve.....11

Grafiku 10: Sektorët në vitin 2014.....12

Grafiku 11: Sektorët në vitin 2015.....12

Grafiku 12: Sektorët në vitin 2016.....12

Grafiku 13: Sektorët në vitin 2017.....12

Grafiku 14: Sektorët në vitin 2018.....12

Grafiku 15: Sektorët në vitin 2019.....12

Grafiku 16: Komponentët e inovacionit në përqindje.....13

Grafiku 17: Sipërmarrësit e rinj.....13

Grafiku 18: Projektet e mbështetura.....14

1 HYRJE

Ky raport statistikor përmban të dhënat ndër vite për ecurinë dhe zbatimin e fondeve të menaxhuara nga AIDA, në shifra konkrete të buxhetit, aplikimeve dhe përfituesve. Gjithashtu, në këtë raport gjenden dhe analiza të të dhënave ndër vite me qëllim pasqyrimin e impaktit të këtyre politikave në mjedisin ekonomik dhe atë të bërjes biznes nga ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme shqiptare.

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 e 7, të ligjit nr. 8957, datë 17.10.2002, "Për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme", i ndryshuar, dhe të neneve 5 e 7, të ligjit nr. 10303, datë 15.7.2010, "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, (AIDA)", me propozimin e Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave vendosi t'i alokonte AIDA-s për menaxhim, 4 (katër) fonde publike në ndihmë të biznesit të vogël dhe të mesëm vendas.

Këto fonde publike u financuan nga buxheti i shtetit, çdo fillim viti të ri kalendarik, si dhe kishin qëllimin t'i shtoheshin buxhetit të kompanive për të realizuar nevojat e tyre në kuadër të zhvillimit.

Fondet janë mbështetur mbi skemën me ndarje të kostove duke lejuar kompanitë të kontribuonin me pjesën e tyre të financimit në projekt.

Skemat e mbështetjes financiare kanë qenë përqëndruar, kryesisht, në katër prioritet kryesore të Qeverisë dhe nevojave të ekonomisë shqiptare, duke dhënë kështu mbështetje për zhvillimin e konkurrueshmërisë së NVM-ve shqiptare dhe nxitjen e eksporteve; mbështetjen dhe nxitjen e zhvillimit të kapaciteteve të sipërmarrjeve të reja Start-Up në vend; rritjen e kapacitetit teknologjik dhe inovativ të NVM-ve, si edhe mbështetje të potencialit krijues të industrisë së ekonomisë kreative në Shqipëri.

Fondi i Konkurrueshmërisë që i përgjigjet zhvillimit të konkurrueshmërisë së NVM-ve shqiptare dhe nxitjes së eksporteve; Fondi në Mbështetje

të Sipërmarrjeve të Reja Start-Up me qëllim zhvillimin e kapaciteteve të tyre të biznesit; Fondi i Inovacionit që synonte rritjen e kapacitetit teknologjik dhe inovativ të NVM-ve; Fondi i Ekonomisë Kreative në mbështetje të potencialit krijues të industrisë së ekonomisë kreative në Shqipëri.

Secili fond u menaxhua dhe realizua mbështetur në bazat ligjore të krijuara nga KM dhe MZHETTS, (sot MFE) në bashkëpunim me AIDA-n, konkretisht: VKM, rregullore specifike, formate të aplikimit, formate të marrëveshjeve, formate të monitorimit.

Në përfundim të çdo viti kalendarik, kryhej monitorimi i përfituesve të këtyre fondeve bazuar në formatet e miratuara të monitorimit dhe hartohet një raport përmbledhës mbi gjetjet dhe arritjet për secilën kompani fituese.

METODOLOGJIA

Ky punim është mbështetur në përmbushjen e disa objektivave kryesore ndër të cilat, përmendim:

- Rishikimin e literaturës për sa i përket NVM-ve në Shqipëri, e cila shërben për të bazuar më tej punën në përgatitjen e punimit.
- Rishikimin e bazës ligjore mbi financimin për NVM-të shqiptare.
- Rishikimin e të dhënave të gjeneruara ndër vite mbi financimin e NVM-ve shqiptare nga AIDA.
- Analizimin e të dhënave të mbledhura.
- Paraqitja e përfundimeve për çështjet e bëra objekt studimi në këtë punim.

Për realizimin e këtij punimi është përdorur një metodologji që bazohet në mbledhjen e të dhënave sekondare dhe analizimin e tyre. Janë përdorur të dhënat sekondare të brendshme, të cilat janë gjeneruar nga raporte të brendshme të AIDA-s mbi realizimin e secilës skemë granti ndër vite, për periudhën e marrë në referencë në këtë punim.

Pjesa më e konsiderueshme e të dhënave është siguruar nëpërmjet shfrytëzimit të publikimeve

dhe raporteve të bëra nga stafi menaxhues i skemave të grantit brenda AIDA-s, si: raportet finale vjetore mbi realizimin e skemave, raporte progresive, raporte monitorimi të zbatimit të projekteve përfituese.

Bazuar në të dhënat e mbledhura janë ngritur pyetjet kërkimore të mëposhtme dhe gjatë punimit i është dhënë përgjigje, pikërisht, këtyre dy pyetjeve.

Pyetjet kërkimore të ngritura në këtë punim, janë:

1. A është dhënë mbështetje financiare për zhvillimin e NVM-ve nga ana e Qeverisë Shqiptare?

-Kjo pyetje është e një rëndësie të veçantë për sa i përket organizimit të punimit, pasi shërben si mbështetëse dhe për pyetjen e dytë të ngritur. Nismat për zhvillimin e ndërmarrjeve vendase të vogla dhe të mesme, me mbështetje financiare dhe teknike, krijojnë një klimë miqësore të bërjes biznes brenda vendit me synimin e zgjerimit të tregut të produkteve/shërbimeve shqiptare. Kjo pyetje merr përgjigje në pjesën e parë të punimit me paraqitjen e të dhënave të mbledhura.

2. Cili ka qenë ndikimi i mbështetjes financiare të ndërmarrjeve vendase të vogla dhe të mesme në klimën ekonomike në Shqipëri?

-Duke pasur në konsideratë skemat e grantit të ofruara për NVM-të shqiptare gjatë periudhës 2014-2019, në pjesën e dytë të punimit do të jepen të dhëna të përpunuara dhe analizuar për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetje dhe për të paraqitur ndikimin e këtyre skemave në klimën ekonomike në Shqipëri.

LIGJI PËR NVM-TË SHQIPTARE

Për të rregulluar ndërmarrjet e vogla dhe të mesme sot, në Shqipëri, qëndron në fuqi ligji nr. 10 042, datë 22.12.2008, për disa ndryshime e shtesa në ligjin nr. 8957, datë 17.10.2002 "Për Ndërmarrjet e Vogla e të Mesme", i ndryshuar. Ky ligj, ndër të tjera, parashikon përkufizimet si më poshtë:

-Ndërmarrjet klasifikohen, në: mikrondërmarrje, ndërmarrje të vogla dhe ndërmarrje të mesme.

-Kategoria e mikrondërmarrjeve dhe Ndërmarrjet

të Vogla e të Mesme, (NVM) përfshin ato ndërmarrje, ku punësohen më pak se 250 veta dhe që realizojnë një shifër afarizmi dhe/ose një bilanc total vjetor jo më të madh se 250 milionë lekë.

-Ndërmarrje e vogël quhet një ndërmarrje, ku punësohen më pak se 50 persona dhe e cila ka një shifër afarizmi dhe/ose bilanc total vjetor jo më të madh se 50 milionë lekë.

-Mikrondërmarrje quhet një ndërmarrje, ku punësohen më pak se 10 persona dhe e cila ka një shifër afarizmi dhe/ose bilanc total vjetor jo më të madh se 10 milionë lekë.

-Për qëllime statistikore ndërmarrjet do të klasifikohen, në:

mikrondërmarrje: 0 deri 9 persona, ku brenda këtij grupimi të detajohen në 0-1 persona dhe 2-9 persona.

ndërmarrje të vogla, 10 deri 49 persona

ndërmarrje të mesme, 50 deri 249 persona.

TË DHËNA PËR NVM-TË NË SHQIPËRI SIPAS INSTAT

Në vijim jepen të dhënat mbi NVM-të në Shqipëri, referuar INSTAT, për vitin 2014 dhe vitin 2019, në formë krahasimore me njëri-tjetrin, për të kuptuar sesi ka ndryshuar mjedisi i biznesit në vendin tonë për periudhën që kemi marrë në shqyrtim.

Në vitin 2019, krahasuar me vitin 2014, numri i ndërmarrjeve që ushtrojnë aktivitet ekonomik u rrit nga 112.537 në 162.342 ndërmarrje aktive. Gjithashtu, edhe numri i njësisve lokale u rrit nga 124,508 njësi lokale aktive në vitin 2014, në 172.296 njësi lokale në vitin 2019, të regjistruara në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Në vitin 2014, ndërmarrjet e mëdha me 50 e më shumë të punësuar përfaqësonin 1.3 % të ndërmarrjeve gjithsej, krahasuar me vitin 2019, ku kjo shifër ka rënë në 1,2%. E njëjta gjë edhe për kontributin e tyre në punësim, shumë të ndjeshëm me 50 % në vitin 2014 dhe 47,8% në vitin 2019.

Në vitin 2019, për nga ndarja rajonale, rajoni më i zhvilluar është rajoni qendër ku përfshihen qarqet Tiranë dhe Elbasan, ku janë përqendruar 50,1 % e ndërmarrjeve aktive. Ndërsa, në vitin

2014 ishte një shifër prej rreth 52,6% e ndërmarrjeve aktive që janë përqendruar në qarqet Tiranë e Fier. Mbizotërimi i prodhuesve të shërbimeve është dukuri në të gjitha qarqet, dhe luhetat nga 80,0 % në qarkun Fier, deri në 87,7% në qarkun Tiranë.

Në vitin 2019, të punësuarit në Tiranë dhe Elbasan zënë 54,9% të të punësuarve gjithsej.

Aktiviteti ekonomik tregtar mbizotëron ndaj aktiviteteve të tjera, me 30,6%. Kjo dukuri është e njëjtë si në nivel qarku, ashtu edhe në nivel bashkie.

Në vitin 2019 ndërmarrjet që ushtrojnë aktivitetin në më shumë se një vendndodhje janë 1.815, të cilat përfaqësojnë vetëm 1,1% të ndërmarrjeve aktive gjithsej. Numri i të punësuarve në to është 26,6% e të punësuarve gjithsej. Aktivitetet financiare kanë numrin më lartë të të punësuarve për ndërmarrjet që kanë më shumë se një vendndodhje.

Për vitin 2019, ndërmarrjet me pronarë apo bashkëpronarë të huaj zënë 4,0 % të ndërmarrjeve aktive dhe punësojnë 11,9% të të punësuarve gjithsej. Në vitin 2014, ndërmarrjet e huaja e të përbashkëta, 5.245 ndërmarrje kanë pronarë apo bashkëpronarë të huaj. 5,6% e tyre janë ndërmarrje me 50 e më shumë të punësuar dhe punësojnë 74,2% të të punësuarve, të ndërmarrjeve me pronësi të huaj e të përbashkët.

Ndërmarrjet me pronarë apo bashkëpronarë me origjinë italiane dhe greke përfaqësojnë 53,4 % të ndërmarrjeve të huaja e të përbashkëta gjithsej, shifër kjo në rënie për vitin 2019, krahasuar me vitin 2014 që ishte 55,4%. Në vitin 2019, ndërmarrjet e huaja e të përbashkëta janë përqendruar kryesisht në qarqet Tiranë dhe Durrës, me 77,1 % tregues zbritur, në krahasim me vitin 2014 ku ishte 81,2%.


Në vitin 2019, krahasuar me vitin 2014, ka një rënie të femrave pronare/administratore të ndërmarrjeve aktive nga 28,5 % në 25,4%.

Në vitin 2014, në ndërmarrjet me 50 e më shumë të punësuar, gratë drejtonin 20,3% të ndërmarrjeve, shifër në rënie kjo në vitin 2019 ku vetëm 16,1% e ndërmarrjeve me 50 e më shumë të

punësuar zotërohen apo menaxhohen nga femrat. Në vitin 2019, ndërmarrjet e drejtuara nga gratë janë, kryesisht, ndërmarrje me 1-4 të punësuar, të cilat zënë 90,5% të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve të drejtuara nga gratë.


Qarku i Tiranës ka edhe përqëndrimin më të madh të ndërmarrjeve të drejtuara nga gratë, me 32,4% në vitin 2019, nga 30,7% që ishte në vitin 2014. Përqëndrimi më i ulët i ndërmarrjeve të drejtuara nga femrat është në Dibër dhe në Kukës.

Grafiku 1: Përqëndrimi i NVM-ve sipas viteve




Grafiku më sipër jep një pasqyrim krahasues midis ndërmarrjeve me aktivitet ekonomik dhe atyre të njësive lokale. Viti 2019, pasqyrohet me një performancë më të mirë në të dy treguesit dhe numri i ndërmarrjeve me aktivitet ekonomik ka pësuar rritje me 44%, si dhe numri i njësive lokale ka pasur një rritje me 38%, krahasuar me vitin 2014.

Grafiku 2: Ndërmarrjet me aktivitet ekonomik kundrejt atyre lokale




Grafiku më sipër jep një pasqyrim krahasues midis ndërmarrjeve me aktivitet ekonomik dhe atyre të njësive lokale. Viti 2019, pasqyrohet me një performancë më të mirë në të dy treguesit dhe numri i ndërmarrjeve me aktivitet ekonomik ka pësuar rritje me 44%, si dhe numri i njësive lokale ka pasur një rritje me 38%, krahasuar me vitin 2014.

Grafiku 3: Kontributi në punësim i ndërmarrjeve me mbi 50 të punësuar



Në grafikun e mësipërm pasqyrohet lidhja midis ndërmarrjeve me më tepër se 50 të punësuar kundrejt kontributit në punësim që këto ndërmarrje japin. Kontributi që ato japin në totalin e të punësuarve në vendin tonë arrin shifrën 50%, që është një shifër mjaft e konsiderueshme, duke marrë parasysh se numri i këtyre ndërmarrjeve nuk është shumë i lartë, vetëm 1.30% në vitin 2014, apo 1.20% në vitin 2019, ku edhe ka pësuar një rënie me 0.1%.

Grafiku 4: Gratë në biznes



Ky grafik mundëson pasqyrimin e situatës së përfshirjes së grave në biznes. Viti 2019, shfaqet me performancën më të lartë në treguesin e numrit të ndërmarrjeve me administratore/pronare femër në Tiranë, ku shihet një rritje me 1.7%, krahasuar me vitin 2014. Nga ana tjetër, dy treguesit e tjerë na paraqiten me rënie për sa i përket femrave administratore në ndërmarrje me më tepër se 50 të punësuar, me 4.2%, si dhe femrave administratore/pronare të ndërmarrjeve në përgjithësi me 3.1%.

2 FONDET E MENAXHUARA NGA AIDA

FONDI I KONKURRUESHMËRISË

Fondi i Konkurrueshmërisë, (FK) është krijuar për herë të parë me VKM nr. 419, datë 15.5.2013 "Për krijimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë".

Fondi Shqiptar i Konkurrueshmërisë u zbatua për një periudhë 3-vjeçare, gjatë viteve 2013 dhe 2014, me një vlerë prej 20 000 000 (njëzet milionë) lekë për secilin vit, ndërsa për vitin 2015, me një vlerë prej 28 000 000 (njëzet e tetë milionë) lekë. Më pas FK u rinovua me anë të VKM-së nr. 24, datë 20.01.2016, me vlerë totale 84 000 000 lekë për periudhën 2016-2018, respektivisht me vlerë totale vjetore prej 28 000 000 lekë për vit.

Pas përfundimit të periudhës 2016-2018, FK u rinovua dhe vazhdoi të funksiononte përsëri nëpërmjet urdhrit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 102, datë 19.03.2019 "Për miratimin e rregullores së funksionimit të Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë". Qëllimi i këtij fondi ka qenë mbështetja dhe përmirësimi i vazhdueshëm i kapaciteteve të NVM-ve shqiptare, në mënyrë që ato të jenë në gjendje t'u përgjigjen kërkesave të tregut ndërkombëtar, si dhe të rrisin punësimin.

Skema rimbursonte shpenzimet e miratuara në përputhje me udhëzimet e mëposhtme:

- Një ndërmarrje mund të përfitojë maksimalisht 1,400,000 lekë për një projekt.
- Skema mbulon 70% të kostove të pranuar brenda limitit të mësipërm.
- Pagesa e fondit të përfituar bëhet 50% në fillim të projektit dhe 50% në përfundim të projektit, kundrejt faturës/faturave e cila/të cilat vërteton/vërtetojnë shpenzimet e kryera, të cilat do të dorëzohen në përfundim të projektit.
- Në një vit, mund të asistohet 1 projekt për çdo ndërmarrje. Pranimi i aplikimeve është subjekt i disponueshmërisë së fondeve dhe mund të pezullohet në çdo kohë në rast se fondet kanë mbaruar. Në rast të tillë, pranimi i aplikimeve dhe miratimi i granteve mund të rifillojë vetëm pas plotësimit të SGNK me fonde.

Sektorët kryesore që ka mbuluar fondi, janë:

- Sektori i industrisë së perpunimit aktiv (fasonet).
- Sektori i industrisë së lehtë.
- Sektori i agropërpunimit.
- Sektori i kërkimit dhe zhvillimit.

Skema e fondit mbulonte shpenzimet për aktivitetet e mëposhtme:

- Certifikim produkti.
- Pjesëmarrje në panairë jashtë vendit (kostot e pranueshme, janë: pagesa për qiranë e stendës, pagesa për organizmin dhe arredimin e stendës, kostot e udhëtimit dhe akomodimit për 1 person përfaqësues të subjektit pjesëmarrës).
- Promovim, publikim dhe hartim materialesh promovues.
- Përshtatje produkti – duke përfshirë ambalazhim dhe etiketim.
- Krijim faqesh në internet dhe zhvillim të tregtisë elektronike
- Shërbime këshillimore (në këtë rast kostot që mund të bashkëfinancohen nuk mund të jenë më shumë se 50 % e kostos totale të projektit të paraqitur).

FONDI NË MBËSHTETJE TË SIPËRMARRJEVE TË REJA START-UP

Fondi në Mbështetje të Sipërmarrjeve të Reja "Start Up", (FMSRSU) është miratuar me VKM-në fillestare nr. 593, datë 10.9.2014, "Për krijimin e Fondit në Mbështetje të Sipërmarrjeve të Reja "Start-Up".

Fondi u krijua me një vlerë të përgjithshme 25 000 000 lekë (njëzet e pesë milionë) lekë, për një kohëzgjatje zbatimi 4 (katër) vjet, për periudhën 2014-2017. Fondi i krijuar filloi të zbatohet në vitin 2014 me këtë shtrirje kohore dhe sipas vlerave të mëposhtme:

- a) Për vitin 2014, vlera e fondit 2 000 000 (dy milionë) lekë
- b) Për vitin 2015, vlera e fondit 4 000 000 (katër milionë) lekë
- c) Për vitin 2016, vlera e fondit 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë
- d) Për vitin 2017, vlera e fondit 9 000 000 (nëntë milionë) lekë

Ky fond është rinovuar me anë të bazës ligjore VKM nr. 210, datë 20.4.2018, për një periudhë

zbatimi prej 3 vjetësh, nga 2018 - 2020, me vlerë të përgjithshme 30 000 000 lekë dhe me vlerë totale vjetore respektivisht 10 000 000 lekë për secilin vit.

Skema rimbursonte shpenzimet e miratuara në përputhje me udhëzimet e mëposhtme:

- Një ndërmarrje mund të përfitojë maksimalisht 500.000 (pesëqind mijë) lekë për projekt
- Skema mbulon 70% të shpenzimeve të miratuara brenda limitit të mësipërm.
- Pagesa e fondit të përfituar bëhet 50% në fillim të projektit dhe 50% në përfundim të projektit, kundrejt faturës/faturave e cila/të cilat vërteton/vërtetojnë shpenzimet e kryera, të cilat do të dorëzohen në përfundim të projektit.
- Fondi nuk mund të jepet më tepër se një herë për të njëjtën sipërmarrje.
- Pranimi i aplikimeve është subjekt i disponueshmërisë së fondeve dhe mund të pezullohet në çdo kohë, në rast se fondet kanë mbaruar. Në rast të tillë, pranimi i aplikimeve dhe miratimi i granteve mund të rifillojë vetëm pas plotësimit me fonde.

Sektorët kryesore që ka mbuluar fondi, janë:

- Sektorët prodhues dhe të shërbimit.
- Sektorin e industrisë së lehtë.
- Sektorin e turizmit.
- Fushën e kërkimit dhe të zhvillimit.
- Procesin e agropërpunimit.
- Fushën e dizenjimit, modelimit, artizanatit.

-Fondi nuk mund të jepet më tepër se një herë për të njëjtën sipërmarrje.

-Pranimi i aplikimeve është subjekt i disponueshmërisë së fondeve dhe mund të pezullohet në çdo kohë, në rast se fondet kanë mbaruar. Në rast të tillë, pranimi i aplikimeve dhe miratimi i granteve mund të rifillojë vetëm pas plotësimit me fonde.

Skema e fondit mbulonte shpenzimet për aktivitetet e mëposhtme:

- Investime në pajisje dhe teknologji për nxitjen e prodhimit/shërbimit.
- Marketing të produktit dhe promovim, (me përjashtim të reklamave elektronike dhe televizive).

- Kualifikim dhe trajnim për rritjen e aftësive sipërmarrëse, të dëshmuar me certifikatat përkatëse.
- Krijim faqesh në internet, publikime materialesh promovuese.
- Pjesëmarrje në panair ose ekspozitë brenda apo jashtë shtetit, si vizitor apo ekspozues.

FONDI I INOVACIONIT

Fondi i Inovacionit, (FI) u krijua për herë të parë në vitin 2011 me VKM nr. 667, datë 28.09.2011 "Për krijimin e Fondit të Inovacionit". Kjo VKM qëndroi në fuqi deri në vitin 2014 duke mbështetur NVM-në shqiptare, respektivisht me vlerën totale vjetore të fondit prej 10.000.000 lekë.

Vendimi i dytë për funksionimin e Fondit të Inovacionit daton në vitin 2015, me anë të bazës ligjore VKM nr. 406, dt. 13.05.2015.

Fondi u krijua me një vlerë të përgjithshme 40 000 000 (dyzet milionë) lekë, për një kohëzgjatje zbatimi 3 (tre) vjet, për periudhën 2015-2017. Fondi i krijuar filloi të zbatohet në vitin 2015, me këtë shtrirje kohore dhe sipas vlerave të mëposhtme:

- Për vitin 2015, vlera e fondit 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.
- Për vitin 2016, vlera e fondit 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë.
- Për vitin 2017, vlera e fondit 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë.

Vendimi i fundit i përket vitit 2018, me anë të bazës ligjore VKM nr. 211, date 20.04.2018 "Për krijimin e Fondit të Inovacionit". Vlera totale e fondit për periudhën 2018 – 2020 ishte 45 000 000 lekë, respektivisht me vlerë totale vjetore prej 15 000 000 lekë.

FI u ka dhënë ndihmë në formë granti të drejtpërdrejtë, ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme. Granti nuk financonte të gjithë kostot, por vetëm një pjesë të tyre, ndërkohë që pjesa tjetër financonet nga përfituesi i grantit (në këtë rast, ndërmarrja shqiptare).

Qëllimi i këtij fondi ka qenë t'i shtohet buxhetit të ndërmarrjes, duke shërbyer si një nxitje për NVM-të për të audituar nevojat e tyre për inovacion dhe teknologji, për të identifikuar furnizues teknologjicë dhe partnerë në shtete të tjera, të ndihmojë dhe lehtësojë promovimin dhe licenci-

min apo patentimin e inovacioneve të NVM-ve duke bërë të mundur që NVM-të përfituese të arrijnë më shumë nga sa ato do të mund të arrinin vetëm me mjetet e tyre.

Fondi i Inovacionit mund të kishte si burim financimi dhe të ardhura nga donatorë apo institucione ndërkombëtare. Në këtë rast, rregullat për përfitimin nga fondi vendoseshin në marrëveshje midis AIDA-s dhe donatorëve apo institucioneve ndërkombëtare.

Skema rimbursonte shpenzimet e miratuara në përputhje me udhëzimet e mëposhtme:

- Një ndërmarrje mund të përfitonte maksimalisht 400 000 lekë për një projekt. Për ndërmarrjet që do të aplikojnë për "blerje pajisjesh teknologjike" financimi do të ishte jo më shumë se 600 000 (gjashtëqind mijë) lekë.
- Skema mbulonte 50% të kostove të pranuar brenda limitit të mësipërm. Përfitimi i ndërmarrjeve nga mbështetja e programeve apo projekteve për mbulimin e 50% të shpenzimeve të tjera të projektit, që nuk mbuloreshin nga Fondi i Inovacionit, duke përdorur fonde nga donatorët apo institucione financiare ndërkombëtare, nuk përbënte pengesë për përfitim edhe nga Fondi i Inovacionit për të njëjtin projekt.
- Paga e fondit të përfituar bëhej 50% në fillim të projektit dhe 50% në përfundim të projektit, kundrejt faturës/faturave e cila/të cilat vërteton/vërtetojnë shpenzimet e kryera të cilat do të dorëzoheshin në përfundim të projektit.
- Në një vit, mund të asistohet 1 projekt për çdo ndërmarrje.
- Pranimi i aplikimeve ka qenë subjekt i disponueshmërisë së fondit dhe mund të pezullohet në çdo kohë, në rast se fondi mbaronte.

Skema e fondit mbulonte shpenzimet për aktivitetet e mëposhtme:

- Auditim të kapacitetit inovativ dhe teknologjik, që synon t'u mundësojë ndërmarrjeve aplikante vlerësimin për nivelin ekzistues të teknologjisë dhe mundësitë për rinovimin e tyre të inovacionit dhe/ose pozicionimit teknologjik, sipas një strukture konkurruese zhvillimi.

-Ndërkombëtarizimin e teknologjisë, e cila synon t'u mundësojë ndërmarrjeve aplikante të identifikojnë dhe të inspektojnë teknologjinë që kërkojnë të përshtatin.

-Pjesëmarrje në panairë inovacioni, teknologjike dhe promovimi, në lidhje me inovacione të ndërmarrjes.

-Blerje pajisjesh teknologjike, që ndikojnë në rritjen e kapaciteteve inovative dhe teknologjike të ndërmarrjes.

-Licenca ose patenta (software ose hardware).

FONDI I EKONOMISË KREATIVE

Fondi i Ekonomisë Kreative, (FKE) është krijuar për herë të parë nëpërmjet VKM-së nr. 954, datë 5.9.2012 "Për krijimin e Fondit të Ekonomisë Kreative, (Artizanati)".

Fondi u krijua me një vlerë të përgjithshme 40 000 000 (dyzet milionë) lekë, për një kohëzgjatje zbatimi 4 (katër) vjet, për periudhën 2013-2016. Për secilin nga vitet 2013, 2014, 2015 dhe 2016, vlera e fondit do të ishte 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

Pas zbatimit të periudhës fillestare, FKE u rinovua me anë të VKM-së nr.15, datë 11.1.2017 "Për krijimin e Fondit të Ekonomisë Kreative (Artizanatit)", për periudhën e re 2017-2019, me buxhet total 30 000 000 lekë dhe vlerë totale vjetore, respektivisht 10 000 000 lekë për vit.

Fondi mbulonte aktivitete që lidhen me artizanatin dhe zejtarinë. Me termin "artizanat" në këtë fond do të kuptohet çdo punë që nuk kryhet industrialisht ku mund të përfshihen, por pa kufizim: produkte tekstili, druri, metali dhe qeramike, stoli, punime kashte, balte, punime në gurë dhe me gurë, punë me mjete rrethanore natyrale, punime me materiale ricikluese, etj.

Sipas parashikimeve të ligjit 70/2016 "Për zejtarinë në Republikën e Shqipërisë", me termin "zejtari" do të kuptohet prodhimi artizanal i produkteve, i cili përcakton se: "zejtaria" është veprimtari ekonomike, nëpërmjet së cilës prodhohen të mira dhe/ose realizohen shërbime zeytare përmes punës me dorë ose në seri dhe, në disa raste, duke përdorur aftësitë krijuese".

FKE u krijua për të mbështetur NVM-të që ush-

trojnë aktivitetin e tyre në sektorin e artizanatit. Fondi ofroi subvencionim për shpenzime që kanë të bëjnë me aktivitete të miratuara mbi bazën e ndarjes së shpenzimeve. Kjo nënkupton se granti nuk financon gjithë shpenzimet, por vetëm një pjesë të tyre.

Në varësi të projektit konkurrues, të përgatitur nga aplikantët, skema mbulonte 80% të kostove të pranueshme dhe të miratuara, por jo më shumë se 500 000 (pesëqind mijë) lekë, ndërkohë që pjesa tjetër financohej nga përfituesi i grantit (në këtë rast ndërmarrja shqiptare).

Skema rimbursonte shpenzimet e miratuara në përputhje me udhëzimet e mëposhtme:

-Një ndërmarrje mund të përfitojë maksimalisht 500 000 lekë për projektin.

-Skema mbulon 80% të shpenzimeve të pranuar, brenda limitit të mësipërm.

-Një ndërmarrje mund të aplikojë vetëm në një ose më shumë nga fushat e parashikuara në pikën 4 të VKM-së nr. 15, datë 11.01.2017.

-Pranimi i aplikimeve është subjekt i disponueshmërisë së fondeve dhe mund të pezullohet në çdo kohë, në rast se fondet kanë mbaruar. Në rast të tillë, pranimi i aplikimeve dhe miratimi i granteve mund të rifillojë vetëm pas plotësimit me fonde.

-Pagesa e subvencionit bëhet 50% me miratimin e projektit dhe 50%, në fund të zbatimit të tij. Pagesa në fund të projektit do të bëhet kundrejt faturave të shpenzimeve të kryera për vlerën e përgjithshme të projektit.

Skema e fondit mbulonte shpenzimet për aktivitetet e mëposhtme:

- Zhvillimi i produkteve të reja, ku mund të përfshihen:

o Dizenjimi.

o Krijimi i prototipeve.

o Konsultimi.

o Përshtatje produkti-duke përfshirë ambalazhim dhe etiketim.

o Certifikimi i origjinës.

-Blerje pajisjesh për nxitjen e prodhimit (makineri dhe pajisje artizanale).

-Marketing produkti, ku mund të përfshihen:

o Certifikimi i produktit.

o Pjesëmarrje në panairë brenda dhe jashtë vendit.

o Promovim, publikim dhe hartim materialesh promovues.

- o Përdorim të shërbimeve specifike të konsullencës.
- o Krijim faqesh në internet dhe zhvillim të tregtisë elektronike.
- o Krijimi i markës dhe emrit të mirë (brandim).
- o Reklamimi në media.
- Kualifikim dhe ndërtim i kapaciteteve manaxheriale të ndërmarrjes aplikuese, ku mund të përfshihen:
- o Zbatim të sistemit të menaxhimit të cilësisë.
- o Shpenzime të trajnimit të stafit brenda dhe jashtë vendit.
- o Institucioni i trajnimit dhe trajnuesit duhet të përzgjidhen sipas praktikës më të mirë. Në shpenzimet që do të mbulohen gjatë udhëtimit jashtë vendit do të merren parasysh disa kritere, si: kostot e udhëtimit ajror (klasi ekonomik). Akomodimi dhe dietat ditore, jo më tepër se 2/3 e normës maksimale për dietat pranuar nga EuropeAid në datën e miratimit të aplikimit.

3 MENAXHIMI I FOND-EVE PËR PERIUDHËN 2014-2019

Për periudhën 2014-2019 Qeveria Shqiptare vuri në dispozicion të mbështetjes së NVM-ve, fondin total prej 355 000 000 lekë, të ndarë sipas fushave përkatëse, konkretisht:


- Fondi i Konkurrueshmërisë, për periudhën referuese, me një total prej 170 000 000 lekë.
- Fondi në Mbështetje të Sipërmarrjeve të Reja Start Up, për periudhën referuese, me një total prej 45 000 000 lekë.
- Fondi i Inovacionit, për periudhën referuese, me një total prej 80 000 000 lekë.
- Fondi i Ekonomisë Kreative, (Artizanatit), për periudhën referuese, me një total prej 60 000 000 lekë.

Kanë aplikuar në total 518 ndërmarrje dhe prej tyre janë mbështetur në total 360 ndërmarrje, pra rreth 70% e aplikuesve kanë qenë aplikime cilësore të vlerësuara nga KAG si fituese të mbështetjes financiare.

Pesha që secili fond ka zënë për periudhën referuese, në terma buxheti të vënë në dispozi-


cion pasqyrohet në grafikun e mëposhtëm:

Grafiku 5: Pesha e secilit fond (në %) mbi buxhetin total për periudhën 2014 – 2019



Grafiku i mësipërm tregon se fondi me peshën më të madhe në buxhet ka qenë FK me 48%, ndjekur nga FI me 22%, FEK me 17% dhe me më pak peshë në buxhet FMSRSU.

Grafiku 6: Aplikimet dhe përfituesit në vite



Ky grafik përmban ndryshimin e aplikimeve nga viti në vit për periudhën referuese. Nga grafiku vihet re se viti me performancën më të lartë në terma aplikimesh është viti 2016, por në terma, përfituesish shfaqet me performancë më të lartë viti 2019, i cili ka dhe numrin më të lartë të ndërmarrjeve të mbështetura në një vit, për periudhën në fjalë.

BUXHETI I DISBURSUAR


Për të kuptuar dhe bërë diferencën midis buxhetit të planifikuar për secilin fond në VKM-të respektive dhe buxhetit faktit të vënë në dispozicion të AIDA-s për mbështetjen ndaj SME-ve, vijmë në ndihmë tabelat e mëposhtme:

Viti 2019 ka pasur performancën më të mirë, krahasuar me vitet e mëparshme të marra në konsideratë, si në terma buxheti ashtu edhe në terma realizimi të tij. Buxheti i parashikuar nuk ka pësuar ndryshime dhe është vënë në dispozicion për financim të NVM-ve, siç është parashikuar

rma realizimi të tij. Buxheti i parashikuar nuk ka pësuar ndryshime dhe është vënë në dispozicion për financim të NVM-ve, siç është parashikuar në VKM-të respektive. Gjithashtu, disbursimi i këtij buxheti është realizuar në masë 91.7%.

Grafiku i mëposhtëm pasqyron buxhetin e disbursuar gjatë periudhës referuese 2014-2019. Të dhënat e grafikut tregojnë peshën e secilit fond mbi totalin e buxhetit të financuar, respektivisht FK ka peshën më të madhe në financimin e NVM-ve me 57%, më pas mbështetjen më të madhe e ka dhënë FEK me 16%, ndjekur nga FMSRSU dhe FI me 15% dhe 12%.

Grafiku 7: Vlera e financuar në periudhën 2014-2019




4 PËRFUNDIME

GRATË SIPËRMARRËSE

Gratë sipërmarrëse kanë aplikuar dhe fituar në të katër skemat e vëna në dispozicion për NVM-të shqiptare. Në grafikun e mëposhtëm pasqyrohen të dhëna mbi përqindjen që zënë gratë sipërmarrëse, ndaj totalit të përfituesve për secilin vit, nga viti 2014 deri në vitin 2019.

Grafiku 8: Gratë sipërmarrëse përfituese



Përqindja ndaj totalit të grave sipërmarrëse të mbështetura në vite ka ardhur duke u rritur. Viti me performancën më të lartë është viti 2018 ku


në total kanë qenë 50% të përfituesve gra sipërmarrëse.

SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Gjatë periudhës 2014 – 2019, AIDA ka ndërmarrë një fushatë promovuese të fondeve nëpërmjet të gjithë kanaleve të informimit. Është bërë informimi dhe promovimi i fondeve nëpërmjet faqes web të AIDA-s, rrjeteve sociale, medias së folur dhe asaj të shkruar. Ndër të tjera, stafi i AIDA-s ka realizuar çdo vit takime me biznese dhe aktorë, ditë informuese, me qëllim promovimin dhe informimin e bizneseve në të gjithë rrethet e Shqipërisë, për të pasur një mbulim dhe shpërndarje sa më të gjerë gjeografike.

Grafiku i mëposhtëm pasqyron mbulimin gjeografik që kanë pasur të katër skemat për periudhën referuese, në përqindje ndaj totalit të përfituesve.

Grafiku 9: Shpërndarja sipas rretheve




NVM-të e rrethit të Tiranës dhe Shkodrës përbëjnë përfituesit kryesorë, me respektivisht 40% dhe 17%. Gjithashtu, nga këto skema në vlera më të ulëta të gjithë rrethet e Shqipërisë.

SHPËRNDARJA SEKTORIALE

Ndërmarrjet aplikuese dhe ato përfituese kanë qenë të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë. Në të dhënat e mëposhtme janë grupuar këto ndërmarrje sipas sektorëve kryesorë.


Sektori i artizanatit, ndryshe nga sektorët e tjerë ka pasur në çdo vit një fond të dedikuar për NVM-të e këtij sektori.

Grafiku 10: Sektorët në vitin 2014



Sektori me më shumë ndërmarrje përfituese ka qenë sektori i tekstilit dhe lëkurë-këpucës me 34%, ndjekur nga sektori i artizanatit dhe sektori i agroindustrisë, respektivisht me 22% dhe 16%.


Viti 2015



Në vitin 2015 ka pasur një ulje të sektorit të tekstilit dhe lëkurë-këpucës dhe një rritje të sektorit të agroindustrisë me përkatësisht 25%, ndjekur nga artizanati me 21% dhe sektori i tekstilit dhe lëkurë-këpucës me 13%. Sektori i bimëve medicinale dhe sektori i plastikës kanë një rritje me 5% nga viti i mëparshëm. Gjatë vitit 2015, për herë të parë ka pasur një rritje të konsiderueshme me 8% të përfituesve nga sektori TIK.

Grafiku 12: Sektorët në vitin 2016


Viti 2016



Gjatë vitit 2016, sektorit artizanatit ka pasur peshën më të lartë të përfituesve me 29%, krahasuar me 21% në vitin 2015. Sektori i agroindustrisë ka pasur 20% të përfituesve, krahasuar me 25% në vitin 2015. Gjithashtu, gjatë këtij viti, ka pasur një rritje të konsiderueshme të sektorit të riciklimit me 9%. Sektori i bimëve medicinale ka një rënie të ndjeshme, krahasuar me vitin e mëparshëm.

Grafiku 13: Sektorët në vitin 2017


Viti 2017



Gjatë vitit 2017, krahasuar me një vit më parë, ka pasur një shpërndarje më të barabartë të përfituesve ku vendin kryesor e zë përsëri sektori i artizanatit. Gjithashtu, gjatë këtij viti, ka pasur një rritje të konsiderueshme të sektorit prodhim i PVC me 7% dhe turizëm me 15%.

Grafiku 14: Sektorët në vitin 2018


Viti 2018



Në vitin 2018, sektori i artizanatit ka pasur peshën më të madhe me 36%, më e larta në të gjithë periudhën 2014-2019.

Grafiku 15: Sektorët në vitin 2019

Viti 2019




Në vitin 2019, sektori i artizanatit ka pasur peshën më të madhe të përfituesve me 32%, ndjekur nga sektori agroindustrisë në rritje me 23%, krahasuar me 15% të vitit 2018. Sektori i tekstilit, lëkurë-këpucës, turizmit së bashku me shërbimet dhe prodhimin e PVC janë pothuajse në të njëjtat nivele me një vit më parë.

EKSPORTUESIT

Ndërmarrjet eksportuese kanë pasur një vend të rëndësishëm në mbështetjen financiare me grant. FK ishte i dedikuar, kryesisht, për zhvillimin e ndërmarrjeve shqiptare eksportuese me qëllim zgjerimin e tregut të tyre. Gjithashtu, ndërmarrje përfituese eksportuese ka pasur edhe në FI.

Grafiku i mëposhtëm pasqyron të dhënat mbi numrin e ndërmarrjeve eksportuese, të cilat kanë përfituar nga skemat financiare. Nga 188 ndërmarrje përfituese gjithësej nga FI dhe FK, 121 prej tyre, ose 64%, kanë qenë eksportues në të paktën një shtet jashtë Shqipërisë.



INOVATORËT


OPr mbështetje nga Fondi i Inovacionit, gjatë periudhës referuese, kanë aplikuar gjithsej 92 ndërmarrje dhe kanë përfituar në total 61 NVM shqiptare, pra 66% e ndërmarrjeve janë mbështetur financiarisht nga FI. 30 prej këtyre ndërmarrjeve kanë marrë mbështetje për auditim inovacioni dhe teknologjie dhe 28 kanë marrë mbështetje për blerje pajisjesh teknologjike. Pjesa tjetër ka krijuar një inovacion për kompaninë e tyre dhe janë 3 NVM, të cilat janë mbështetur për krijim Software.

Pesha që secili komponent i inovacionit zë në mbështetjen e Qeverisë Shqiptare për inovacionin në NVM-të, pasqyrohet në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm:

Tabela 1: Komponentët e inovacionit

Komponenti i inovacionit	Nr. i përfituesve	%
Auditim inovacioni/teknologjie	30	49%
Blerje pajisjesh teknologjike/rinovim teknologjie	28	46%
Software	3	5%
Totali	61	100%

Grafiku 16: Komponentët e inovacionit në përqindje




Grafiku i mësipërm pasqyron peshën e secilit komponent të inovacionit, gjatë periudhës referuese. Sipas të dhënave, ndërmarrjet shqiptare inovative kanë pasur më tepër kërkesa për ekspertizë, për të audituar nevojat për inovacion dhe teknologji me 49% si dhe mbështetje në rinovimin e teknologjisë dhe makinerive me 46%. Kërkesat e ndërmarrjeve shqiptare për komponentin software kanë qenë të ulta në vetëm 5%.

SIPËRMARRËSIT E RINJ

Bazuar në përkufizimin për sipërmarrjet e reja në fuqi për periudhën referuese, Start-Up quhet çdo sipërmarrje e re nga 0 deri në 2 vjet në treg. Mbështetur në këtë përkufizim, pranë AIDA-s kanë aplikuar në total 150 sipërmarrje, si dhe janë mbështetur me grant 95 sipërmarrje të reja shqiptare për periudhën 2014-2019, vetëm nga fondet e vënë në dispozicion për këto sipërmarrje. Sipërmarrjet e reja janë mbështetur jo vetëm nga FMSRSU, por edhe nga fondet e tjera të AIDA-s, duke respektuar rregulloret specifike të fondeve.

Në grafikun e mëposhtëm pasqyrohet shpërndarja e mbështetjes së sipërmarrjeve të reja Start Up, sipas skemave financiare të menaxhuara nga AIDA.

Grafiku 17: Sipërmarrësit e rinj



NUMRI I PUNONJËSVE

Ndërmarrjet klasifikohen, në: mikrondërmarrje, ndërmarrje të vogla dhe ndërmarrje të mesme, sipas ligjit në fuqi nr. 8957, datë 17.10.2002 "Për Ndërmarrjet e Vogla e të Mesme", i ndryshuar.

-Për qëllime statistikore ndërmarrjet janë klasifikuar në:


o mikrondërmarrje: 0 deri 9 persona, ku brenda këtij grupimi të detajohen në 0-1 persona dhe 2-9 persona;

o ndërmarrje të vogla: 10 deri 49 persona;

o ndërmarrje të mesme: 50 deri 249 persona."

Bazuar në klasifikimin e mësipërm, grafiku në vijim jep të dhëna mbi madhësinë e ndërmarrjeve përfituese nga skemat e financimit të menaxhuara nga AIDA.

Vihet re se ndërmarrjet e klasifikuara si mikrondërmarrje zënë pjesën më të lartë të përfituesve, në masën 68%.



PROJEKTET DHE FUSHAT E MBËSHTETJES


Bazuar në rregulloret specifike, secili fond ka mbështetur fusha të caktuara për projekt-aplikime.

Duke respektuar këto rregullore, ndërmarrjet shqiptare që janë mbështetur me fond kanë zhvilluar projekte që mbulojnë fushat, si: krijimi i prototipeve të reja, marketingu i kompanisë, blerje pajisjesh pune apo makineri, certifikime produkti, pjesëmarrje në panair, ambalazhim dhe etiketim, auditim inovacioni dhe teknologjie, software.

Një pasqyrim mbi peshën që secila fushë ka

zënë ndër projektet e shpallura fituese dhe të zhvilluara, jepet në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 18: Projektet e mbështetura



Në grafikun e mësipërm, fusha blerje pajisjesh pune apo makineri, zë pjesën më të madhe të projekteve të mbështetura me 32% të të gjithë projekteve. Rinovimi i teknologjisë apo makineri/pajisje përbën një kërkesë të rëndësishme për ndërmarrjet shqiptare, që ka nevojë për mbështetje të jashtme për arsye të kostove të larta që kanë pajisjet apo makineritë e nevojshme.

Fusha e dytë më e mbështetur është certifikimi i produktit me 25%, sidomos për ndërmarrjet shqiptare që eksportojnë jashtë vendit. Krijimi i prototipeve të reja, që është një karakteristikë e FEK zë, gjithashtu, një peshë të konsiderueshme me 17% të totalit të projekteve të financuara. Më pas renditet fusha e auditimit të teknologjisë dhe inovacionit me 8%, fusha e ambalazhim dhe etiketim produkti me 7%, marketingu i ndërmarrjes me 6%, si dhe pjesëmarrje në panair dhe software, respektivisht me 4% dhe 1%.

5 HISTORI SUKSESI

Të gjitha ndërmarrjet përfituese nga skemat e financimit të menaxhuara nga AIDA, mbartin me vete historinë e tyre të suksesit në rrugëtimin e veprimtarisë ekonomike, si dhe në ndikimin që kanë në klimën e biznesit në Shqipëri. Më poshtë përmbledhen disa nga këto histori suksesti të përfitimit nga mbështetja financiare gjatë periudhës 2014 – 2019.

- **EURO GERS SHPK** (Kantina Arbëri) përfituese e Fondit të Konkurrueshmërisë – ndërmarrja ka realizuar nëpërmjet projekteve të financuara certifikim të produktit, krijimin e ambalazhimeve të reja dhe etiketimit

të produktit. Ky financim i ka ndihmuar në rritjen e mundësive për eksport, duke ndikuar drejtëpërdrejt në shtimin e xhiros vjetore; përmirësimin e promovimit dhe rritjen e vizibilitetit të kompanisë; rritjen e numrit të punëtorëve.

- **EUGEN SKERMO SHPK** (Mjaltë Morava) përfituese e Fondit të Konkurrueshmërisë – ndërmarrja ka realizuar nëpërmjet projekteve të financuara, pjesëmarrjen në dy panairë ndërkombëtare, ambalazhim dhe krijimin e materialeve promovuese. Ky financim i ka ndihmuar në rritjen e mundësive për eksport dhe kontrata të reja; promovimin e produktit në tregjet ndërkombëtare; konkurrim në tregun vendas me një format të ri të paketimit të produktit, rritjen e shitjeve dhe xhiros vjetore.
- **ART HOSTEL** (Antea Goci PF) - përfituese e Fondit Start-Up – ndërmarrja është mbështetur për blerjen e paisjeve të biznesit, konkretisht paisje kuzhine. Pas kryerjes së investimit, ndërmarrja ka rritur ndjeshëm standardet e shërbimit (bazuar mbi deklarin e subjektit gjatë monitorimit dhe nga përshtypjet pozitive të klientëve që janë tregues thelbësor për këtë kategori biznesi). Si rezultat i këtij ndryshimi, ndërmarrja ka pasur rritje me 25% të numrit të klientëve, gjë që përkthehet direkt në rritjen e të ardhurave të subjektit.
- **BLERTA SHAFRAN** (Blerta Feka PF) përfituese e Fondit Start-Up – ndërmarrja është mbështetur për blerjen e paisjeve të punës dhe materialeve të ambalazhim-etiketimit. Investimi i kryer ka ndikuar direkt në rritjen me 20% të kapaciteteve prodhuese të ndërmarrjes dhe në shtimin me 1 punonjës të ri. Gjithashtu, investimi i kryer në ambalazhet e paketimit ka sjellë rritjen e standardeve të shërbimit dhe përmirësimin e kushteve të ruajtjes së produktit, sipas standardeve kombëtare dhe europiane të sigurisë ushqimore.
- **BIO-V"- SHPK** përfituese e Fondit të Inovacionit - ndërmarrja ka realizuar nëpërmjet projektit të financuar auditim për teknologjinë dhe inovacionin. Ky financim i ka ndikuar në përmirësim të diagnozës laboratorike në Shqipëri; ofrimin e shërbimit laboratorik në të gjithë vendin; zgjerim akreditimi; futjen e metodave të reja testuese.
- **Kuld Sh.P.K** – përfituese e Fondit të Inovacionit - ndërmarrja ka realizuar nëpërmjet projektit të financuar blerjen e një pajisje e cila shërbente për matjen e zhurmave. Kjo i bëri të mundur plotësimin e një pjese të ak-

tivitetit mjedisor që ky subjekt zhvillonte, që është monitorimi dhe analizat mjedisore. Ky financim i ka ndikuar në rritjen e numrit të stafit si dhe aplikimin e metodave inovative në përputhje me standardet europiane në fushën e ekspertizës mjedisore.

- **Ilirjan Subashi P.F** përfituese e Fondit të Inovacionit - ndërmarrja ka realizuar nëpërmjet projektit të financuar blerjen e një makinerie për mbushjen e bustinave të vajit, e cila solli për ndërmarrjen shtimin e gamës së produkteve, shtimin e vlerës me një produkt inovator, aksesin e një kanali të ndryshëm shitjeje, atë të restoranteve, garantimin e konsumatorit për autenticitetin e produktit të konsumuar, rritjen e kushteve higjieno-sanitare të përdorimit, uljen e normës së shpërdorimit nga ana e konsumatorëve, përdorimin si produkt promociional në fushata marketingu, si dhe rritjen e imazhit të kompanisë.
- **QENDRA ARTISTIKE ZADRIMA** (Tereza Gega PF) përfituese e Fondit të Ekonomisë Kreative – ndërmarrja ka realizuar nëpërmjet projektit të financuar projektimin e logos dhe krijimin e materialeve promovuese dhe dizenjimin e website-it të kompanisë. Ky financim i ka ndihmuar në krijimin e një identiteti të ri për kompaninë dhe produktet e saj; përmirësimin e imazhit të kompanisë në treg; rritjen dhe trajnimin e punonjëseve të reja. Ndërmarrja është mbështetur, gjithashtu, për pjesëmarrje në një panair ndërkombëtar, ku kanë arritur mundësi promovimi në tregje të huaja si edhe rritjen e nivelit të shitjeve.
- **QËNDISTARI MELIHA ZYBERAJ** (Melih Zyberaj PF) përfituese e Fondit të Ekonomisë Kreative – ndërmarrja ka realizuar krijimin e prototipeve të reja dhe materiale promovuese. Ky financim i ka ndihmuar në rritjen e performancës së kompanisë në treg; mundësi për hyrje në tregje të reja dhe optimizimin e shitjes në tregjet e pranishme; rritjen e numrit të klientëve si rezultat i shtimit të shërbimit. Arritja kryesore ka qenë lidhja e kontratave të reja me hotele dhe restorante, për t'i pajisur me produkte artizanale të personalizuar. Kjo ka ndikuar në shtimin e numrit të punonjëseve dhe trajnimin e tyre. Ndërmarrja është mbështetur, gjithashtu, për pjesëmarrje në një panair ndërkombëtar, ku ka arritur të promovojë produktin e saj në tregje të reja si edhe rritjen e nivelit të shitjeve.

REFERENCA

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve
www.aida.gov.al

Ministria e Financave dhe Ekonomisë
www.financa.gov.al

Instituti i Statistikave
www.instat.gov.al

Qendra e Botimeve Zyrtare
www.qbz.gov.al



invest in Albania



AIDA

Albanian Investment Development Agency
Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve

✉ info@aida.gov.al

🌐 aida.gov.al

☎ +355 (0)42 251 001

🐦 [@investinalbania](https://twitter.com/investinalbania)

📷 [@aida__albania](https://www.instagram.com/aida__albania)

📘 AIDA - Albanian Investment Development Agency